

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Rama në OKB: Algoritmi krijoi narrativën e trilluar për pushtimin izraelit të bregdetit shqiptar - Informohu siç duhet
ADRESA	https://radar.al/rama-ne-okb-algoritmi-krijoi-narrativen-e-trilluar-per-pushtimin-izrael-it-te-bregdetit-shqiptar/
BURIMI	radar.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 19:44:14 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 19:00:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	5bd18cb4b72797f09c35d756ee84f5fa21ec522e5920e703e90745223954dfbc
TEKSTI	e0ac428fb4a396b1d374f8d350724708df5418a443ca3d3b12eb99ef06018ed1
PAMJA	dd37ea6abb6a93eb1bc92aa05b4edc3c8d8eae7bff6ab3e643b3cf32d5713f46

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	b174d26c62c5f8634f85fe80e15f57321a1f4bfd8c92911460ec970af360c6d7
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	f25232b47d2959dc6146897981a0af4e37060d45058c64d9459ab0f54fd17f54
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/b174d26c62c5f8634f85fe80e15f57321a1f4bfd8c92911460ec970af360c6d7>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

YOU ARE AT: Home » Rama në OKB: Algoritmi krijoi narrativën e trilluar për pushtimin izraelit të bregdetit shqiptar

KRYESORE

Demo

Rama në OKB: Algoritmi krijoi narrativën e trilluar për pushtimin izraelit të bregdetit shqiptar

SEPTEMBER 25, 2026



Kryeministri Edi Rama, gjatë fjalës së tij në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara në Nju-Jork, u ndal te ndikimi i algoritmeve dhe Inteligjencës Artificiale në formësimin e perceptimeve publike, duke sjellë si shembull zhvillimet që ai i cilësoi si "revolucionin i flamingove" në Shqipëri.

Rama foli për një narrativë që, sipas tij, u krijua dhe u përhap në rrjetet sociale, lidhur me pretendimin për një pushtim izraelit të bregdetit shqiptar, duke theksuar se një ngjarje e tillë nuk kishte ndodhur.

"Kishim narrativën e trilluar të një pushtimi izraelit të bregdetit shqiptar. Një pushtim që kurrë nuk ndodhi. U fabrikua, u personalizua e u përcoll përmes zërave, faqeve e kanaleve të cilave qytetarët u besonin tashmë. Një qytetar dëgjoi një histori të një provokimi fetar, ndërsa tjetri përftoi konspiracionin e një pushtimi të huaj", deklaroi Rama.

Sipas kryeministrit, i njëjti pretendim u përshtat me perceptimet dhe emocionet e grupeve të ndryshme të qytetarëve, duke krijuar versione të ndryshme të së njëjtës narrativë.

"Trillime të ndryshme hyjnë në botë të ndryshme emocionale, të gjitha në shërbim të së njëjtës gënjeshtre strategjike dhe pasojat ishin reale", u shpreh ai.

Rama tha se qytetarët kishin arsye konkrete për të protestuar, por sipas tij, në një moment protestat nisën të orientoheshin edhe kundër asaj që e cilësoi si një "armik fantazmë".

"Shprehja antisemite hyn në ligjërimin tonë publik për herë të parë ndonjëherë. Mos harroni, Shqipëria është i vetmi vend në Europë që e mbylli Luftën e Dytë Botërore me më shumë hebrenj sesa në fillim të saj. Frika u shndërrua në zemëratë, zemëratë u shndërrua në mobilizim dhe trillimi u shndërrua në realitet politik dhe nuk ishte një eksperiment laboratorik", tha kryeministri.

Duke iu referuar mënyrës se si u përhap kjo narrativë, Rama theksoi se bëhej fjalë për një situatë konkrete të jetës politike dhe shoqërore në Tiranë, dhe jo për një skenar hipotetik.

"Ky nuk ishte një film fantastiko-shkencor, por ishte thjesht një e martë në Tiranë", deklaroi ai.

Sipas Ramës, algoritmi nuk ishte ai që përcaktoi objektivin, por u përdor nga aktorë njerëzorë për të identifikuar mënyrat se si mund të aktivizoheshin emocionet dhe ndarjet ekzistuese në shoqëri.

"Algoritmi nuk shpiku objektivin. Ishte një aktor njerëzor që e bëri këtë. Algoritmi nuk e zhvilloi, nuk e ndezi urrejtjen, por zbuloi si ta aktivizonte urrejtjen tonë. Ky është mashttrim sistematik si shërbim",

Postimet e reja

Aksident i rëndë, alpinisti 28-vjeçar humb jetën pa...

SEPTEMBER 25, 2026

Rama në OKB: Algoritmi krijoi narrativën e trillua...

SEPTEMBER 25, 2026

Tensione në qiell/ Avionët suedezë dhe finlandezë...

SEPTEMBER 25, 2026

Zjarr i madh në bazën ushtarake britanike, një...

SEPTEMBER 25, 2026

Mos e humb

FOKUS | SEPTEMBER 24, 2026

Dosja/ Biznesmeni Meqemeja i dha Ahmetajt 140 mijë euro! SPAK: Shpërblim për Inceneratorin e Fierit përmes shitjeve fiktive

Biznesmeni Sokol Meqemeja njihet si pronar i disa kompanive apo sipërmarrjeve. Përveç 'Delvina Gas' ai...

ALERT në Sloveni për VIPA
Flips të Kosovës, kanë përmbytje të alergjenësh.
Produkti hiqet nga tregu

Kreditorët te dera, gjykata në kërkim të "Top Fruits" të Ejup Ahmetit dhe Marin Gjonajt: Paraqituni në gjyq

Kompania e krijuar tri ditë pas hapjes së thirrjes për grantet e startupeve fitoi 6.1 milionë lekë në fazën e rezervuar për biznese të paktën 1-vjeçare

Na ndiq

tha Rama.

Kryeministri e lidhi këtë fenomen edhe me mënyrën se si mund të zhvillohet ndërhyrja në procese zgjedhore në epokën e teknologjisë dhe Inteligjencës Artificiale.

Sipas tij, ndërhyrjet nuk kërkojnë më domosdoshmërisht një televizion të madh apo një propagandë që i drejtohet në të njëjtën mënyrë të gjithë popullsisë, pasi mesazhet mund të përshtaten sipas profilit dhe perceptimeve të secilit votues.

“Tashmë mund të veprojë me vendosmërinë e secilit prej votuesit. Kur kjo ndodh demokracia nuk humbet thjesht një debat apo thjesht një radhë zgjedhjesh. Humbet terrenin e përbashkët mbi të cilin bëhet i mundur debati dhe humb edhe mundësinë për ta pasur atë”, tha Rama.

Në vijim, ai e lidhi këtë zhvillim me konceptin e sovranitetit, duke argumentuar se në shekullin XXI mbrojtja e një shteti nuk lidhet vetëm me territorin, ujërat dhe hapësirën ajrore.

“Sovraniteti nuk gërryhet më në kufij. Në shekullin XX sovraniteti nënkuptonte kontrollin mbi tokën, ujërat territoriale dhe hapësirën kombëtare ajrore. Sot në Europë ne po vrapojmë si të marrë për të shtuar gjithmonë e më shumë, për të hedhur gjithmonë e më shumë para që nuk i kemi për të mbrojtur tokat tona, për të mbrojtur qiejt tanë”, u shpreh kryeministri.

Rama tha se krahas mbrojtjes së territorit dhe hapësirës ajrore, shtetet duhet të marrin në konsideratë edhe aftësinë e shoqërive për të mbrojtur kushtet në të cilat qytetarët formojnë opinionet e tyre.

Sipas tij, nëse kjo aftësi mungon, mbrojtja e sovranitetit territorial dhe ajror nuk është e mjaftueshme.

“Duhet që kjo të nënkuptojë edhe aftësinë e një shoqërie të lirë për të mbrojtur kushtet në të cilat qytetarët e tyre formojnë opinionin e vet. Pa këtë aftësi, sovraniteti mbi tokën, mbi qiejt bëhet thjesht një iluzion”, përfundoi Rama.

OKB rama

SHARE.



RRETH NESH



Një shikim i thellë në botën e lajmeve, ku teknologjia dhe profesionalizmi takohen për të sjellë lajmet më të fundit dhe të rëndësishme brenda dhe jashtë Shqipërisë. Një burim i besueshëm për informacionin e saktë dhe analizat gjithëpërfshirëse.

NIPT: M47705501A
Email: radarlaime@gmail.com
Kontakt: +355689008000

HOROSKOPI

Horoskopi/ Parashikimi i yjeve për ditën e sotme, 24 Shtator 2026

Njohje të reja për beqarët, mundësi fitimi dhe sfida në punë, çfarë thonë yjet për ju sot

Universi ka një surprizë për këto 3 shenja më 14 shtator



Aleanca për Media Etike

Artikull joetik?

raporto këtu

© Radar.al. dizenuar nga 1001solutions

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.